



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*  
*Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health*

30 Prill 2020  
Nr. Xx/2020

Bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr. 05/L -031 - Për procedurën e përgjithshme administrative, nenin 38 të Ligjit 04/L-190- Për Produkte dhe Pajisje medicinale, nenin 17 të Udhëzimit Administrativ 02/2019 - Për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, Vendimin nr. protokollit 35/2019, datë 27.06.2019, me rastin e shqyrtimit të kërkesës me Nr. 30, të datës 26.03.2020, nga Kompania **Jonapharm**, me seli në Prishtinë, me adresë: Lagjja e Vneshtave, Leka i Madh, p.n me person përgjegjës **Teuta Balidemaj**, të ushtruar kundrejt vendimit të komisionit për çmime të publikuar më 23 Mars në webfaqen e MSH, Komisioni për çmime, në takimin e mbajtur me datë 30.04.2020, nxjerr këtë:

**VENDIM**

Nuk aprovohet kërkesa për rishqyrtim të çmimeve e parashtruar nga Kompania **Jonapharm**, me seli në Prishtinë, me adresë: Lagjja e Vneshtave, Leka i Madh, p.n.

**Arsyetimi**

Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht komisioni për çmime bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve medicinale pas zhvillimit të procedurave të parapara me aplikacionet, dhe evalumin e tyre më datë 23 Mars 2020 ka publikuar vendimin për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale të cilat posedojnë autorizim për marketing pranë AKPPM. Bazur në paragrafin 1 të nenit 17 kundër vendimit të komisionit pala ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim në komisionin për çmime në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimeve.

Kompania **Jonapharm**, me seli në Prishtinë, me adresë: Lagjja e Vneshtave, Leka i Madh, p.n, bazuar në paragrafin 1 të nenit 17 të UA 02/2019, brenda afatit ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim të çmimeve të produkteve medicinale si vijon

1. Tamsulozin PhS, Tamsulosin hydrochloride, 0.4 mg, Modified release capsule,hard,30 cap. për të cilin ka aplikuar për çmimin produkti nuk posedon certifikate te Marketing Autorizimit dhe poashtu nuk ka deklaruar çmim në aplikacion

Komisioni duke u bazuar në dispozitat e udhëzimit administrativ përkatësisht në paragrafin 2 të nenit 17 të UA 02/2019 ka përcaktuar si vijon:

MAH: PHARMAS D.O.O.-CROATIA

Emri i produktit	INN	Forma farmaceutike	Fortesia	Madhesia e paketimit	Çmimi i deklaruar	Çmimi në € në vendet referente/origjinës	Çmimi final në Euro	Komenti nga komisioni
Tamsulozin PhS	Tamsulosin hydrochloride	0.4 mg	Modified release capsule, hard,	30 modified-release capsules, hard				MA e skaduar MA-3062/2808713 e skaduar me 28.08.2018

Nga sa u tha u vendos si në dispozit të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Pala ka të drejtë ankese 15 ditë kalendarike pas shpalljes së kësaj përgjigjeje në Bordin për Ankesa për çmime të produkteve medicinale në Ministrinë e Shëndetësisë.

Komisioni për çmime:

1. Naim Bardiqi MSH kryetar
2. Selvete Shuleta AKPPM anëtare
3. Etrit Tetova AKK anëtar
4. Amir Keka FSSH anëtar

5. Shkumbin Jusufi OFK anëtar
6. Dardan Nallbani anëtar MT
7. Blerta Kika MF anëtare

  
\_\_\_\_\_  
  
\_\_\_\_\_

Vendimi i dërgohet:

Palës,

Departamenti farmaceutik,

Arkivës.